



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:231747
Datë: 18.01.2024
Numri i dokumentit: 05205158

C-IV-14-1302

Parashtruesi i kërkesës

S P, nga Gjakova, të cilin e përfaqësojnë avokatët T B, nga Gjakova dhe Sh B, nga Prishtina,
Kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit – AKP (N.SH. “Modeli” në Likuidim), Rr. “Dritan Hoxha”
nr. 55, Lakërishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 18 janar 2024, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- I. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PEJ150-0183 datës 21 janar 2014.**
- III. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 12 shkurt 2014, pranë DHPGJS ankuesi parashtror një kërkesë, të emërtuar padi-ankesë, për anulimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (në tekstin e mëposhtëm AL) PEJ150-0183 datë 21 janar 2014 (në tekstin e mëposhtëm Vendimi), me të cilin i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensimin e 24 (dy katër) pagave të papaguara, në shumë prej 5,280.00 (nëntë zero pese katër nëntë) Euro, ndaj N.SH “Modeli” (në Likuidim).

Ankuesi pohon se NSH i ka mbetur borxh paga të papaguara, në shumën e kërkuar, i cili fakt nuk është kontestuar nga përfaqësuesit e NSH.

Ankuesi tutje pohon, se ishte punëtor, në marrëdhënie të rregullt pune pranë NSH dhe se të njëjtit me rastin e privatizimit i takon e drejta në kompensim në shumën e kërkuar si palë e dëmtuar.

Ankuesi e kundërshton Vendimin e AL sa i përket parashkrimit duke ju referuar Ligjit për punën e bashkuar dhe konsideron se ky ligj është i pa-aplikueshëm dhe në kundërshtim me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane mbi të drejtat e Njeriut.

Nga gjitha arsyet e cekura si më lartë i propozon gjykatës që kërkesa e tij të aprovohet duke përfshirë edhe kamatën ligjore.

Kërkesës për rishikim i është bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 18 qershor 2021 parashtroj përgjigjen.

AKP kundërshtoj pretendimet e ankuesit si të pabazuara. AKP pohon se vendimi i AL është nxjerrë në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për AKP (shtojca e ligjit) andaj edhe pretendimet e ankuesit janë të pabazuara. Tutje pohon se, kërkesa kreditore e ankuesit është parashkruar në kuptim të dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP respektivisht Ligjit mbi punën e bashkuar – LPB. AKP i referohet vendimeve të DHPGJS. Nga të gjitha arsyet propozoj që ankesa të hedhet si e papranueshme ose të refuzohet si e pabazuar dhe vendimi i atakuar të vërtetohet.

Përgjigjes i është bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL.

Përgjigja e AKP ju dorëzua përfaqësuesit të ankuesit, avokat Sh B, me 23 korrik 2021.

Nuk është parashtruar përgjigje.

Me urdhëresat e gjykatës, datë 21 korrik 2021 dhe 1 nëntor 2013, nga përfaqësuesit e ankuesit u kërkua që të parashtrojnë kopjen e autorizimit për përfaqësim.

Përfaqësuesit nuk kanë përmbushur urdhrin, por megjithatë gjykata gjeti një kopje të autorizimit grupor, duke përfshirë edhe nga ankuesi, i cili autorizim është bashkangjitur në shkresa të lëndëve tjera të punëtorëve lëndë këto në të cilat zhvillohet procedura gjyqësore pranë kësaj gjykate. Kopja e një autorizimi është bashkangjitur shkresave të lëndës.

Arsyetimi ligjor

Kërkesa për rishikim-ankesa konsiderohet e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për DHPGJS (ligji nr.06/L-086) në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Kërkesa për rishikim – ankesa është parashtruar kundër Vendimit të AL me të cilin është vendosur lidhur me kërkesën mbi pagat e pa- paguara, subjekt i kërkesës gjersa pranë AL, sipas po këtij Vendimi, nuk ka pasur kërkesë mbi kompensimin për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës si kategori e veçantë kërkesash sipas Shtojcës së Ligjit për AKP.

Gjykata në kuptim të nenit 74 të Ligjit për DHPGJS shqyrton kërkesën kundër Vendimit të AL, me të cilin vendim është vendosur sipas kërkesës së ankuesit.

Në rastin konkret bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankueses, që në parashtresat e saj me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyetimit ligjor mbi të cilin vendos

qëndrimin dhe argumentimin e saj. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesja, të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Nga dispozita e cekur si më lartë, është obligim i ankuesit që të dëshmoj detyrimet ndaj tij, mbi mos pagesën e të ardhurave personale.

Lidhur me pagat e papaguara si dhe kompensimit, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 parashihet përmbushja e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person.

Nga dispozita e lartë cekur, mund të konkludohet se, punëtori gëzon të drejtën në paga respektivisht dëmshpërblim nëse:

- a. Pagat e punonjësit, në këtë rast ankuesit, nuk janë paguar.

Tutje sipas nenit 40 paragrafi 1.7 parashihet përmbushja e kërkesave përfshirë kërkesat e pasiguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë

Në këtë rast ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH i ka mbetur borxh pagat e kërkuara, ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me lartësinë dhe llogaritjen e pagave të kërkuara. Për më tepër ankuesi ka dështuar që të dorëzojë prova relevante si ato se NSH i ka mbetur borxh pagat e pa-paguara Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa-paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj, ankuesi, nuk ka dëshmuar të drejtën e tij mbi pagat ashtu siç edhe parashihet sipas nenit 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 por edhe paragrafit 1.7 (kërkesat e pasiguruara) të po të njëjtit nen, si edhe nuk ka dëshmuar ndonjë obligim tjetër ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS.

Nga gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet gjyqësore

Ankuesi ka paguar taksat gjyqësore.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqta